# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-461557**

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | SAPC në Tiranë, integrimi në BE dhe projekti në Zvërnec në fokus të diskutimeve, eurodeputetët vizitojn ë zonën me Ballën – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/negociatat-me-be-ne-sapc-mbeshtet-ambicien-e-shqiperise-per-mbylljen-e-procesit-ne-2027/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 23 shtator 2026, 05:04:54 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 22 shtator 2026, 14:37:35 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `815e59683cff44c5cf3c0467c45e193a449b68a4a4f063844f472dc52250d0dd` |
| TEKSTI | `da3610c763551e9e5597cb9d155ced1a3e58554df33155cec6ddbfa07b7874dd` |
| PAMJA | `2dcf55c7b39aa74d5468c654f418e2cd081c0c7c1fa42498e27cbadc69906184` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `9931164313aaf84e508231c9968527417679b517026092a9e87c4d59ef7653bd` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `4a111ad93b0774e4315d3f6f441e1591ae8aff5c47e01d9c0b726a490b4da86a` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/9931164313aaf84e508231c9968527417679b517026092a9e87c4d59ef7653bd`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Tiranë takimin e 22-të, ku në fokus ishin procesi i integrimit europian, reforma në drejtësi, lufta kundër korrupsionit, turizmi dhe zhvillimi i qëndrueshëm.

Në deklaratën e përbashkët, përfaqësuesit e Parlamentit Europian dhe Kuvendit të Shqipërisë vlerësuan hapjen e negociatave për gjashtë grupkapituj dhe mbylljen e përkohshme të tre kapitujve. U theksua ambicia e Shqipërisë për të përmbyllur negociatat e anëtarësimit deri në fund të vitit 2027.

Në fokus ishte edhe forcimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e gjyqësorit dhe rezultatet e strukturave kundër korrupsionit, përfshirë SPAK. SAPC kërkoi vijimin e reformave dhe ruajtjen e pavarësisë së institucioneve të drejtësisë.

Në kuadër të takimit, anëtarët e delegacioneve zhvilluan edhe një vizitë në Vlorë dhe Zvërnec, ku u diskutua zhvillimi i turizmit dhe ndikimi i investimeve në ekonomi, së bashku me detyrimin për mbrojtjen e zonave me vlera ekologjike.

REKLAMË

Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla, tha se gjatë vizitës në Zvërnec, përfaqësuesit e qeverisë dhe agjencive përgjegjëse informuan delegacionin se angazhimet mjedisore për zhvillimin e turizmit synojnë të përmbushin ose tejkalojnë kërkesat e Bashkimit Europian.

5 Korça "zgjohet" nga tërmeti, lëkundjet ndihen në qytet dhe zonat...

NEWSLETTER

**Përmbledhja e ditës në e-mail**

emaili juaj

Abonohu

REKLAMË

Sipas Ballës, projekti i planifikuar në këtë zonë synon të jetë një shembull i investimeve të mëdha ndërkombëtare të realizuara në përputhje me standardet europiane, duke kombinuar investimin, përgjegjësinë mjedisore dhe krijimin e vlerës për komunitetin dhe ekonominë vendase.

Balla theksoi gjithashtu se projekti parashikon mbrojtjen e vijës bregdetare dhe ekosistemeve natyrore, ndërsa përfitimet ekonomike synohet të gjenerohen përmes punësimit vendas, zhvillimit të aftësive profesionale, përfshirjes së bizneseve shqiptare dhe rritjes së aktivitetit ekonomik në rajonin e Vlorës. Sipas tij, rëndësi e veçantë do t'u kushtohet sipërfaqeve të gjelbra, mbjelljeve dhe ruajtjes së karakterit natyror të zonës.

/vizionplus.tv

#SAPC


WRITTEN BY
**Redaksia Web**
Gazetar/e · Vizion Plus



Të gjithë artikujt →


## Vazhdo të lexosh




POLITIKË

**Shkarkimi i Hysenit, Balla: PS nuk bën...**

Taulant Halili · 22 Sht 22:46



POLITIKË

**Bardhi-Begajt: Para se të dekretosh...**

Taulant Halili · 22 Sht 21:58



POLITIKË

**Begaj dekreton shkarkimin nga dety...**

Taulant Halili · 22 Sht 21:06


REKLAMË


## Lini një koment

**Komenti juaj** *

Me respekt — komentet moderohen nga redaksia.

**Emri** *

**E-mail** *

Nuk publikohet kurrë.

☐ Ruaje emrin dhe e-mailin tim në këtë shfletues për herën tjetër që komentoj.

**Posto komentin**




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.